



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 794/1 Prot.

Tiranë, më 16.02.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1580, datë 09.10.2012.

**SHOQËRISË “SILDO & ARLI” SH.P.K**  
Rruga “Dervish Hima”, Nr. 54, Burrel

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA**  
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “SILDO & ARLI” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1580, datë 09.10.2012, për mineralin Krom, në objektin “Komuna Derjan”, rrethi Mat, bashkia Mirditë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.461, datë 25.01.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.794, Prot, datë 26.01.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1580, datë 09.10.2012, për mineralin Krom, në objektin “Komuna Derjan”, rrethi Mat, bashkia Mirditë pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit mineralar lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit për vitin 2020-2021.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Mineralar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Mineralar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1580, datë 09.10.2012, për mineralin Krom, në objektin “Komuna Derjan”, rrethi Mat, bashkia Mirditë që shoqëria Juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1580, datë 09.10.2012, për mineralin Krom, në objektin “Komuna Derjan”, rrethi Mat, bashkia Mirditë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ILIR BEJTJA**

